

Debat nacional për Bashkimin Evropian

Anketë debative për përfitimet dhe sfidat nga anëtarësimi eventual i
Maqedonisë në BE

Çka është anketë debative?

Anketë debative është një formë unike e konsultimeve politike, e cila i kombinon teknikat e sondazhit të opinionit publik dhe diskutimit publik. Ajo synon të paraqes se si do të dukej opinionin publik për një temë të caktuar, nëse qytetarët do të kishin mundësi të njihen më shumë me temën. Anketa debative i pasqyron preferencat dhe opinionet e qytetarëve si para ashtu edhe pas njoftimit të detajuar me temën.

Modeli i të anketuarve

Anketa bazë

Para mbajtjes së ngjarjes debative, u realizua anketa e modelit reprezentativ prej 1200 të anketuarve nga gjithë shteti, në periudhën nga 1 deri më 7 nëntor të vitit 2017. Mënyra e rekrutimit: zgjedhje e rastësishme. Përkatësia etnike: maqedonas 67.4%; shqiptarë 24%.

Pas ngjarjes debative

Pas përfundimit të ngjarjes debative më 18/19 nëntor 2017, u anketuan 150 qytetarë për çështje dhe tema të njëjta, sikur nga anketa bazë. Mënyra e rekrutimit: rekrutim në terren me ftesë dhe sipas zgjedhjes personale. Përkatësia etnike: Maqedonas 78.9%; shqiptarë 10.6%.

Ngjarja debative

Ngjarja debative u mbajt më 18 – 19 nëntor të vitit 2017, në hotel “Kontinental” në Shkup. Gjatë këtyre dy ditëve, 150 qytetarë, të ndarë në 11 grupe të moderuara, u arsimuan dhe informuan midis tyre në lidhje me atë se çka do të fitonte Maqedonia ose çka do të humbiste me rastin e integritit eventual në Bashkimin Evropian, edhe atë në dy fusha: **demokraci** dhe **ekonomi**. Pastaj, secili nga grupet parashtronin pyetje panelit të ekspertëve dhe politikanëve nga spektri i përgjithshëm, me synim që të ndërtojnë qëndrime të informuara dhe të paanshme. Sesionet plenare ishin vetëm pyetje dhe përgjigje, pa fjalime të lira të panelistëve.

Rezultatet


Në vazhdim ua prezantojmë rezultatet e **ndryshimit të qëndrimeve të qytetarëve**, të cilët morën pjesë në anketën bazë dhe në anketën pas ngjarjes debative. Rezultatet në vazhdim i pasqyrojnë vetëm **vlerat përfundimtare Pro ose Kundër** ndonjë pyetje.

1. Pyetjet kryesore lidhur me perceptimet për Bashkimin Evropian dhe reformat e nevojshme

Pyetje	Para debatit	Pas debatit	Komenti
Sa e mbështesni anëtarësimin e Maqedonisë në BE?	52.2% plotësisht e mbështesin anëtarësimin në BE	63.7% plotësisht e mbështesin anëtarësimin në BE	Mbështetje e rritur për 11.5% pas debatit.
A i plotëson Maqedonia kriteret demokratike për t'u integruar në BE?	11.5% konsiderojnë se Maqedonia i përmbush plotësisht kriteret demokratike për BE	5.3% konsiderojnë se Maqedonia i përmbush plotësisht kriteret demokratike për BE	Pas debatit, për 6.2% u reduktua perceptimi për gatishmërinë momentale të Maqedonisë për BE.
Çfarë lloji të reformave mbështesni? Të udhëhequra nga Qeveria ose shoqëria civile?	27.2% janë për reforma të udhëhequra nga QRM 13.4% janë për reforma të udhëhequra nga shoqëria civile	19.4% janë për reforma të udhëhequra nga QRM 20.6% janë për reforma të udhëhequra nga shoqëria civile	Qytetarët dëshirojnë pjesëmarrje thuaja se të barabartë të QRM dhe shoqërisë civile në procesin reformues.
Në cilat sfera nevojiten reforma urgjente?	<ul style="list-style-type: none"> 68% - sundimi i së drejtës 78% - reforma në gjyqësor 63.7% - reforma në media 	<ul style="list-style-type: none"> 75.3% - sundimi i së drejtës 85.5% - reforma në gjyqësor 76.2% - reforma në media 	Mbi 70% konsiderojnë se prioritet urgjent duhet t'u përkushtohet reformave në pjesën e sundimit të së drejtës, gjyqësorit dhe mediave.


2. Sa do të ndihmonte integrimi i Maqedonisë në BE në rastet në vijim

2.1. Demokracia



Një numër i madh i qytetarëve konsiderojnë se anëtarësimi në BE është i domosdoshëm për demokratizimin thelbësor të shtetit.

2.2 Ekonomia



Anëtarësimi në BE, në nivel afatgjatë, do ta përmirësonte zhvillimin ekonomik të shtetit, konsiderojnë 44% e qytetarëve. Për 54.6%, anëtarësimi në BE në masë të madhe do ta përmirësonte standardin jetësor.

3. Anëtarësimi i Maqedonisë në BE dhe çështja e emrit

Përgjigje	Para debatit	Pas debatit
Tërësisht e kundërshtojnë integrimin në BE për shkak të frikës nga ndryshimi i identitetit nacional	30%	19,6%
Nuk e mbështesin integrimin e Maqedonisë në BE për shkak të insistimit për ndryshimin e emrit kushtetues	29,8%	28,8%
Konsiderojnë se zgjidhja e kontestit me emrin është i domosdoshëm për integrimin në BE	35%	46%
Nuk pajtohen fare se Maqedonia duhet ta ndryshoj emrin kushtetues për anëtarësimin në BE	31.4%	32.9%
Fuqishëm e mbështesin ndryshimin e emrit kushtetues nëse garantohet emri Maqedonas dhe gjuha maqedonase	28.1%	40,9%

Emri dhe çështjet e identitetit ndikojnë fuqishëm mbi perceptimin e qytetarëve për anëtarësimin në BE. 19,6% fuqishëm e kundërshtojnë këtë për shkak të frikës nga ndryshimi i identitetit nacional. Megjithatë, nëse garantohet emri Maqedonas dhe gjuha maqedonase, 41% e qytetarëve do ta pranonin ndryshimin e emrit kushtetues të shtetit.

Konkluzione

Është evident **ndryshimi i perceptimit** të qytetarëve pas debatit nacional për BE. Një numër i madh i qytetarëve konsiderojnë se anëtarësimi i shtetit në BE është shumë i rëndësishëm, veçanërisht në pjesën e reformave demokratike dhe ekonomike. Nga ana tjetër, një numër shumë i vogël i qytetarëve konsiderojnë se Maqedonia i përmbush kriteret demokratike për anëtarësim në BE. Një numër i madh i tyre janë për reforma urgjente në pjesën e sundimit të së drejtës, gjyqësorit, administratës dhe mediave. Evidente janë pritshmëritë pozitive nga reformat ekonomike dhe përfshirja e vendit në rrjedhat ekonomike të BE.

Emri është një çështje sensitive e cila seriozisht ndikon mbi perceptimet për BE. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm i qytetarëve do ta pranonin ndryshimin e emrit kushtetues të shtetit nëse garantohet gjuha maqedonase dhe identiteti.

Përfshirja e qytetarëve në debatet për integrimin evropian të vendit **ndikon seriozisht mbi të kuptuarit e tyre kritik** të procesit, ndërkaq **efekti është mbështetje e rritur** për anëtarësimin në BE. Ngjarjet debative të këtij lloji e rrisin gatishmërinë e qytetarëve për ballafaqimin me përfitimet dhe sfidat nga anëtarësimi i Maqedonisë në BE. Është e pakontestueshme se integrimi evropian ndikon mbi shumë sfera të jetës politike dhe mbi jetën e qytetarëve, së këtejmi buron nevoja për debat inkluziv dhe të vazhdueshëm demokratik me të gjithë faktorët në këtë proces.